



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 22
Prishtinë, më 03 shkurt 2016, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Synavere Rysha, Hajdar Beqa, Naim Fetahu dhe Duda Balje.

Munguan: Besnik Bislimi, Bali Muharremaj dhe Enver Hoti.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatorë e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi në Komision, Arjeta Luli, praktikante dhe Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ-i.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: Erëza Pula- GSJP, Sanije Berisha- OSBE, Sylejman Blaku- Kosova Sot, Dren Ajeti- GLPS dhe Resmije Ballazhi- Ekonomia Online.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.12.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komisionit për vitin 2015;
4. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2016;
5. Shqyrtimi i kërkesës së ZAP-it, për emërimin e auditorëve të jashtëm për pasqyrat vjetore financiare të ZAP-it;
6. Inicimi i procedurave për Auditimin e Subjekteve Politike, për vitin 2015;
7. Ndryshimi i vendimit të grupit punues, për shqyrtimin e Projektligjit për ZAP-in;
8. Të ndryshme.

Zv. Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Zv. Kryetari- konstatoi që aprovet rendi i ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.12.2015

Zv. Kryetari- konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 10.12.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komisionit për vitin 2015

Zv. Kryetari- përmes këtij raporti paraqiten aktivitetet e komisionit nga janari deri në dhjetor të vitit 2015. Bazuar në fushëveprimin e komisionit, përveç tjerash është edhe shqyrtimi i raporteve të auditimit të jashtëm të hartuara nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike gjatë vitit 2015 ka pranuar nga ZAP- i gjithsej 114 raporte të auditimit, prej tyre 100 janë raporte të pasqyrave vjetore financiare dhe 14 janë raporte të performancës. Nga këto raporte të pranuar, komisioni ka arritur të shqyrtojë 59 raporte të auditimit dhe kjo është arritur në 21 mbledhje të mbajtura dhe 3 dëgjime publike. Po ashtu komisioni ka arritur t'i nxjerr 84 rekomandime. Komisioni ka shqyrtuar Projektligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe e ka aprovuar në lexim të parë. Po ashtu komisioni ka realizuar dy vizita jashtë vendit, vizita në Tiranë në shkurt 2015, Konferenca e Shteteve të Ballkanit Perëndimor me temën “ Mbikëqyrja Buxhetore Financiare në Ballkanin Perëndimor” dhe vizita studimore në Gjermani, në muajin shtator 2015. Po ashtu, Kryetari i Komisionit dhe anëtarët tjerë, kanë pasur takime me komisionet tjera, me shoqërinë civile, takimet me përfaqësues të institucioneve si dhe takimet me donator të ndryshëm siç është paraqitur në raport, gjithsej ishin 15 takime. Komisioni ka arritur të nxjerr rekomandime për 12 organizata buxhetore, ndërsa janë adresuar për Seancë Plenare raportet e auditimit bashkë me rekomandime për 7 organizata buxhetore.

Zv. Kryetari- e hap diskutimin për Raportin e Punës së Komisionit për vitin 2015.

Hajdar Beqa- ky raport është një raport i detajuar dhe konsideroj që i përmbledhë të gjitha aktivitetet që duhet të ketë një raport i punës së komisionit, prandaj e përgëzoj stafin mbështetës për punën që e ka bërë.

Duda Balje- raporti vjetor i punës është shumë përmbajtësor dhe ka paraqitur aktivitetet e komisionit të realizuara gjatë vitit 2015, megjithatë kishte me qenë mirë që në raport të paraqiten edhe ato aktivitete për të cilat komisioni nuk ka arritur t'i përmbushë gjatë vitit 2015, si dhe të përcaktohen shkaqet që e kanë penguar komisionin në arritjen e objektivave.

Përfundim

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, njëzëri miratoi Raportin e Punës së Komisionit për vitin 2015.

4. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2016

Zv. Kryetari- ashtu siç kërkohet me rregullore të punës së Kuvendit, komisioni duhet të përgatitë planin e punës si dhe planin financiar të komisionit. Administrata e komisionit ka përgatitur planin e punës së komisionit dhe planin financiar për vitin 2016, bazuar në fushëveprimin e komisionit. Sipas këtij plani të punës, komisioni ka paraparë që gjatë vitit 2016, të bëjë shqyrtimin në lexim të dytë të Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe këtë t'a adresojë për Seancë Plenare. Po ashtu komisioni planifikon shqyrtimin e kërkesës së ZAP- it për përzgjedhjen e kompanisë audituese për auditimin e pasqyrave vjetore financiare të ZAP –it për tri vitet e ardhshme, e jo vetëm për një vit ashtu siç ka qenë deri tani. Po ashtu komisioni planifikon përgatitjen e termave të referencës për auditimin e pasqyrave vjetore financiare dhe të deklarimit financiar të subjekteve politike. Shqyrtimi i propozim vendimit të Presidentes për kandidatin për Kryesues të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Shqyrtimin e raporteve kthyesë të organizatave buxhetore, që lidhen me implementimin e rekomandimeve të dhëna nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike. Shqyrtimi i raporteve të performancës të përgatitura nga ZAP- i. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Shpenzimeve të Qeverisë për vitin 2015. Vizitë anëtarët e komisionit një organizate buxhetore të caktuar për të parë nga afër funksionimin e institucionit të caktuar (për këtë komisioni vendos në ndërkohë). Shqyrtimi i raporteve të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të institucioneve për

vitin 2015, për institucionet e audituara. Shqyrtimi i raportit vjetor të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Buxhetit të Kosovës për vitin 2015, etj. Po ashtu në planin vjetor të punës për vitin 2016, janë paraqitur nga GIZ- i edhe disa aktivitete të parapara të zhvillohen në KMFP, e që nuk janë pjesë e materialit që ne u kemi shpërndarë më parë. Sipas GIZ- it, parashihet që në muajin maj 2016 të jetë një vizitë studimore në Gjermani, së bashku me anëtarët e komisionit të buxhetit. Po ashtu Dëgjim Publik lidhur me raportin e performancës së komunave për vitin 2015. Gjithashtu takim i përbashkët me Komisionin për Buxhet dhe Financa, për të bashkërenduar aktivitetet lidhur me rishikimin buxhetor. Nëse ndonjëri nga deputetët mendon ndryshe nga materialet që ju kemi dërguar, atëherë ju lutëm paraqitni propozimet e juaja. Me këtë hapi diskutimin.

Naim Fetahu- bazuar në planin vjetor të punës së KMFP-së për vitin 2016, si dhe patur parasysh fushëveprimin e komisionit, mendoj se ky plan është i përgatitur mirë dhe me aktivitete të veçanta. Për çdo ndryshim gjatë vitit nga plani fillestar ne mund ta rishikojmë atë. Andaj ju ftojë që ta përkrahim dhe ta votojmë ashtu siç është punuar nga administrata e komisionit.

Synavere Rysha- plani i punës së KMFP-së është i përgatitur mjaft mirë, për këtë e falënderojmë stafin mbështetës të Komisionit. Patur parasysh rrethanat që po punojmë ky plan mund të rishikohet.

Zv. Kryetari- pasi nuk pati të interesuar për të diskutuar e hodhi në votim planin e punës së KMFP-së dhe planin financiar të komisionit për vitin 2016.

Përfundim

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, njëzëri miratoi Planin e Punës bashkë me planin financiar të Komisionit për vitin 2016.

5. Shqyrtimi i kërkesës së ZAP-it, për emërimin e auditorëve të jashtëm për pasqyrat vjetore financiare të ZAP-it.

Zv. Kryetari- theksoi se bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, Kuvendi i Republikës së Kosovës përmes Komisionit për Mbikëqyrje të

Financave Publike, përzgjedh kompaninë audituese për auditimin e pasqyrave vjetore financiare të ZAP- it. Kërkesa nga menaxhmenti i ZAP- it është që kjo përzgjedhje të bëhet për periudha më afatgjatë, në rastin konkret për tri vite. Përvoja e deritanishme ka treguar se përzgjedhja për çdo vit e operatorit ekonomik, po paraqet vonesa dhe kjo po reflekton në vonesat e dorëzimit të raportit vjetor të punës së ZAP- it për vitin gjegjës, ashtu siç kërkohet me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm.

Në rastin konkret po kërkohet nga komisioni që të merr veprimet e nevojshme, që përzgjedhjen e kompanisë audituese t'a bëjë për tri vite fiskale, pra për vitet 2015, 2016 dhe 2017.

Vlenë të theksohet se viteve paraprake komisioni ka përzgjedhur kompani audituese vetëm për një vit fiskal dhe shuma e mjeteve që është shpenzuar për këtë qëllim nuk kalon 3,000 euro. Me këtë hapi diskutimin, meqenëse nuk pati të interesuar për të diskutuar me këtë e hodhi në votim propozimin e ZAP-it.

Përfundim

Të autorizohet Administrata e Kuvendit, përkatësisht Drejtoria për Prokurim, të bëjë përzgjedhjen e kompanisë audituese, për auditimin e pasqyrave vjetore financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitet 2015, 2016 dhe 2017.

6. Inicimi i procedurave për Auditimin e Subjekteve Politike, për vitin 2015.

Zv. Kryetari- theksoi se në Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike, kërkohet që Kuvendi, përkatësisht Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike të përzgjedh së paku 10 auditorë për auditimin e Raporteve Financiare dhe Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës për Subjektet Politike. Edhe viteve paraprake Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike ka nxjerrë rekomandim për Kryesinë e Kuvendit, e më pas Kryesia ka autorizuar administratën e Kuvendit që të inicojë procedurat për përzgjedhjen e auditorëve për auditimin e këtyre raporteve financiare. Pra në rastin konkret të pambuluara me auditim kanë mbetur raportet financiare dhe ato të deklarimit financiar të fushatës për subjektet politike, përkundër rekomandimeve të Komisionit dhe Kryesisë së Kuvendit, kjo punë nuk është kryer. Tani ne po shqyrtojmë mundësinë e nxjerrjes së një rekomandimi për auditimin e raporteve financiare dhe të fushatës së subjekteve politike, jo vetëm për vitin 2015 ashtu siç kërkohet me këtë ligj, që Kuvendi gjatë muajit janar të zgjedh këta auditorë, por edhe për vitin 2013 dhe 2014, që kanë mbetur të pa audituara. Nga komisioni kërkohet që të nxjerrë një rekomandim për Kryesinë e Kuvendit, që t'a

autorizojë administratën e Kuvendit për inicimin e proceduarave për përzgjedhjen e së paku 10 auditorëve për auditimin e raporteve financiare dhe të fushatës së subjekteve politike, për vitin 2015, apo nëse është mendimi i juaj edhe për vitin 2013 dhe 2014. Me këtë hapi diskutimin.

Naim Fetahu- theksoi se Ligji për Kuvendin është në procedurë të shqyrtimit dhe shpresojmë se rregullohet qeshtja e raportimit të agjensioneve të pavarura që janë të themeluara nga Kuvendi si dhe të auditimit të subjekteve politike.

Synavere Rysha- auditimi i raporteve financiare të subjekteve politike, është një qeshtje që na ka përcjellur gjatë tërë vitit 2015. Mendoj që kishte me qenë mirë që auditimi i raporteve financiare me u bërë për një kohë më të gjatë, pra për tri vite 2013, 2014 si dhe 2015, të cilat nuk kan arritur të kryhen deri më tash, edhe pse ne si komision kemi kërkuar vazhdimisht.

Hajdar Beqa- mendoj se për vitin 2015 të nxirret një rekomandim nga KMFP për auditim të raporteve financiare të subjekteve politike, ndërsa për vitin 2013 dhe 2014, të analizohet se bashku me sekretarin se a ekzistojnë mundësit buxhetore për këtë, me pastaj në mbledhje të radhës të vendosim.

Zv. Kryetari- theksoi se në mbledhje të radhës të thirret Sekretari i Kuvendit për të diskutuar dhe me pastaj të vendoset për këtë.

Përfundim

KMFP vendosi që kjo pikë e rendit të ditës të diskutohet në mbledhjen e radhës dhe për këtë të ftohet edhe Sekretari i Kuvendit.

7. Ndryshimi i vendimit të grupit punues, për shqyrtimin e Projektligjit për ZAP-in.

Zv. Kryetari- Ashtu siç jeni në dijeni, në kohën kur është bërë aprovimi në parim i Projektligjit është themeluar edhe grupi punues në përbërje, Besnik Bislimi- Kryetar, Hajdar Beqa- antarë dhe Synavere Rysha- antare. Për shqyrtimin e Projektligjit dhe përgatitjen e rekomandimeve për lexim të dytë, megjithatë në mungesë të Kryetarit të Komisionit si kryesues i këtij grupi, komisioni nuk ka mundur që të mblidhet dhe të shqyrtojë në detaje Projektligjin. Meqenëse neve

po na kalon afati ligjor për shqyrtimin e këtij projektligji, atëherë do të ishte mirë që ne të nxjerrim një vendim të ri për grupin punues, që do të merret me shqyrtimin e Projektligjit të Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Naim Fetahu- tha se është mirë të ndryshon vetëm kryesuesi i grupit punues, që ishte Besnik Bislimi, në vend të tij të jeni Ju z.Ali Sadriu, meqenëse edhe po e kryesoni komisionin në vend të z.Bislimi.

Zv. Kryetari- propozoi, të ndryshohet vendimi për Kryesues të grupit dhe anëtareve të grupit punues për shqyrtim të Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, dhe në këtë grup punues të jenë të gjithë deputetët e KMFP-së, që janë sot këtu dhe në ndërkohë mund të bashkangjiten edhe anëtarët e tjerë të komisionit.

Përfundim

KMFP vendosi që kryesues i grupit punues për shqyrtim të Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, të jetë z.Ali Sadriu, ndërsa anëtarë të gjithë deputetët tjerë të pranishëm në këtë mbledhje (Duda Balje, Hajdar Beqa, Naim Fetahu dhe Synavere Rysha)

8. Të ndryshme

Zv. Kryetari- propozoi që KMFP, të mbajë një punëtori jashtë objektit të Kuvendit me të gjithë deputetët për të shqyrtuar Projektligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Përfundim

KMFP njëzëri vendosi që të organizojë një punëtori për shqyrtim të projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zv. Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu